Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0762

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092), si dhe nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së 08. 09. 2023, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Astraplan" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë" me numër të prokurimit 214-22-10936-5-1-1, me 23/11/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE "Astraplan" SH.P.K. me nr. 2023/0762, e datës 05/10/2023, kurse vendimi i AK Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë" me numër të prokurimit 214-22-10936-5-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Astraplan" SH.P.K.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 14.10.2022, Policia e Kosovësnë cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Stacionit Policor Veri Prishtinë" me numër të prokurimit 214-22-10936-5-1-1.

Me 15. 09. 2023, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ku ka rekomanduar OE "Pro & Co Group" shpk.

OE “Astraplan” SH.P.K. me datën 25.09.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 28. 09. 2023, AK – Policia e Kosovës me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues “Astraplan”, me datën 05.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0762, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigjet e AK-së në kërkesën për rishqyrtim

- *Përgjigja e parë (I):*AK sqaron se asnjë nga pretendimet ankimore nuk qëndron për arsyet në vijim: Neni 105 është ne kompetencë te plote te OSHP- dhe AK nuk ka kompetencë te drejtat dhe detyrimet ky pretendim është i pa bazuar. Pretendimi 2 - AK nuk ka bere shkeljeje te nenit 6 pasi AK është siguruar se fondet publike te ndara për aktivitetin e prokurimit ne fjale duke siguruar se fondet do te përdoren vetëm për projektin ne fjale sipas qëllimit te këtij aktivitetit te prokurimit. Ju jeni eliminuar për arsye qe nuk keni plotësuar kriteret administrative andaj konsideroheni te papërgjegjshëm dhe pretendim është i pa bazuar. Pretendimi 3 -AK nuk ka ber shkelje të nenit 7 pasi ne asnjë forme apo mënyrë nuk ka diskriminuar apo favorizuar asnjë OE për faktin se AK ka shpallur procedurë te hapur për aktivitetin e prokurimit dhe te gjithë OE janë trajtuar te barabartë pasi i kanë pasur ne te njëjtën kohe informata dhe gjitha kushtet për tenderin ne fjalë dhe te gjitha ofertat i ka trajtuar ne mënyrë te barabartë me kërkesat e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë ky pretendim është i pa bazuar. Pretendimi 4 AK nuk ka bere shkelje të nenit 59 pasi te gjitha ofertat janë vlerësuar ekzaminuar ne baze te kritereve kualifikuese sipas njoftimit për kontrate dhe FDT-se dhe oferta juaj është eliminuar pasi nuk keni plotësuar kriteret administrative, rrespektivisht Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale andaj jeni konsideruar i papërgjegjshëm mbi bazën e te dhënave te ofruara dhe pretendim juaj është i pa bazuar. Pretendimi 5 -AK nuk ka ber shkelje të nenit 60 si dhe neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale ia Teknike dhe/ ose Profesionale si dhe Nenit 9.1&9.2 te DT-se Kërkesa mbi mundësitë teknike: Autoriteti kontraktues i ka dhëne kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; duke u bazuar ne kriteret e DT dhe Njoftimit për Kontratë. Ju jeni eliminua për arsye te cilat janë dhëne ne Njoftimin mbi Vendim dhe Letrat Standarde si: OE është i papërgjegjshëm pasi nuk ka plotësuar pikat ne vijmë: Ne njoftim për kontrate dhe FDT-se seksioni III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: Një autovinç (Kamion për bartje te materialeve ndërtimore min. 7ton) OE nuk e ka ofruar ketë, pasi qe OE ka ofruar një kamion vinç prej 5 tone e cila është ne kundërshtim me njoftim për kontrate dhe FDT- se. Gjithashtu OE ka ofruar edhe një Koke tërheqëse me kran dhe një Rimorkioi e cila nuk e është sipas njoftim për kontrate dhe FDT-se III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional ku është kërkuar - Një

autovinç (Kamion për bartje te materialeve ndërtimore min 7ton) OE ka ofruar një automjet Koke Tërheqës me kran dhe Rimorkio e jo siç është kërkuar -Një autovinç (Kamion për bartje te materialeve ndërtimore min 7ton). AK nuk ka kërkuar një koke tërheqës me kran dhe një Rimorkio. Kërkesa e AK-se ka qene e qartë sipas njoftimit për kontratë dhe FDT-se - Një autovinç (Kamion për bartje te materialeve ndërtimore min. 7ton). Me poshtë ju dëshmojmë automjetin te cilin OE e ka ofruar një automjet koke tërheqëse me kran me Libreza CRA) me nr: 1923154 me targa 03-524-DE, Koke tërheqëse me krane sipas peshave te librezës; Koka tërheqës me Kran, F Pesha;18000kg (me gjitha peshën bartëse te lejuar), F1 pesha maksimale e ngarkese se lejuar; 7200Kg (72 ton), G Pesha e automjetit 10800kg (pa ngarkesë), Një Rimorkio me Libreza (CRA) me nr. 1542907, targat 03-524- XB, F Pesha;33020kg (me gjitha peshën bartëse te lejuar), F1 pesha maksimale e ngarkese se lejuar 24900kg (24.9 ton), Pesha e automjetit 8120kg (pa ngarkesë). Nga kjo shihet qe OE është i pa përgjegjshëm pasi qe pesha e automjet te ofruar Koke tërheqëse me kran peshën e lejuar për bartje sipas librezës se qarkullimit e ka 7200KG ose (7.2 tone) ndërsa Rimorkio te cilën e ka ofruar e ka peshën pa ngarkesë 8120 KG e qe kjo është ne kundërshtim me rregullat e komunikacioni pasi qe pesha e lejuar për bartje e kësaj koka tërheqës është e lejuar me peshën e bartjes 7200KG ose 7.2 tone, ndërsa Rimorkio ka peshën pa ngarkesë 8120KG me ketë është mbipeshe e kokës tërheqëse. Te gjitha këto janë te dëshmuara me librezë te qarkullimi për Kokën tërheqës edhe Rimorkion e prezantuar ne ofertën financiare te OE Astraplan SH.P.K. pretendimi ne ketë pike është i pa bazuar. Gjithashtu bazuar ne Ligjin mbi Komunikacionin. Ligji Nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor Kuvendi i Republikës së Kosovës; Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Miraton ligj për rregullat e trafikut rrugor kapitulli dispozitat e përgjithshme. Neni 174 Ngarkesa në mjet 1. Mjeti që ndodhet në trafikun rrugor ndalohet të ngarkohet më tepër se masa më e madhe e lejuar, e përcaktuar në certifikatën e regjistrimit të mjetit, ta tejkalojë ngarkesën boshtore të lejuar ose ti tejkalojë mundësitë teknike të rrugës. OE sa i përket pretendimit qe AK nuk i ka kërkuar para rekomandimit dokumentet e pranushmerise, nuk qëndron. OE pretendon qe nuk i kemi ofruar ne qasje te datës 21.09.2023. Ju kemi ofruar qasje te plote dhe te vetmin dokument te cilin e keni kërkuar është Raporti i Vlerësimit. Ndërsa sa i përket dëshmisë qe a janë kërkuar dokumentet ne fjale ekziston dëshmia ne E-prokurim me date 14-15 shtator. Sa i përket pretendimit qe OE nuk i ka ofruar dëshmi te mjaftueshme mbi: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 1,000,000.00 €. Pretendimi nuk qëndron pasi qe ne referencat e ngarkuara ne sistem ne ditën e ofertimit e plotësojnë dhe e tejkalojnë vlerën e kërkuar (1,000,000,00 euro) i dëshmi ju ofrojmë referencën mëposhtëm për te cilën ju pretendoni qe nuk ka ekzistuar ne oferte: Referenca ne vlerë 459,990.26€ dhe gjendët ne oferte financiarë te dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrate.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Astraplan" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi* Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, kundrejt pretendimeve ankimore të OE ankues "Astraplan" SH.P.K., sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 59, 60, 69 dhe 105 të LPP-së, si dhe nenin 40 paragrafin 40.3 të RrUOPP dhe nenin 9.1&9.2 të Dosjes së tenderit "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale".
- *Pretendimi i dytë (II):* OE ankues "Astraplan SH.P.K."- Prishtinë, pretendon kundrejt ofertës së OE të rekomanduar për kontratë "Pro & Co Group SH.P.K.", ku OE ankues pretendon se nga qasja në dokumentet e OE të rekomanduar nuk na janë prezantuar dokumentet si:b) Një

vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës, d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

- *Pretendimi i tretë (III):* OE ankues "Astraplan SH.P.K." pretendon se OE i rekomanduar për kontratë "Pro & Co Group SH.P.K."- Prishtinë nuk plotëson kriteret mbi aftësitë teknike profesionale, përkatësisht nuk plotëson kushtin prej 1,000,000.00 euro, se ka përfunduar me suksese punë të natyrës së njëjtë apo ngjashme, ku i njëjti është i pa përgjegjshëm pretendon ankuesi. Më tej, OE ankues në ankesë potencon se në bazë të listës së kontratave të paraqitura nga OE i rekomanduar, kontrata të cilat duhet ti merren parasysh vlerat e tyre është 629,094.53 euro, ndërsa kontratat me numër rendor 14 dhe 15 nuk duhet të merren parasysh për këto arsye potencon ankuesi: Kontrata me numër rendor 14. Me vlerë 459,990.26 euro, data e nënshkrimit me 27.04.2020 nga grupi i OE Pro & Co Group shpk & Archi Time SHPK dhe N.N.T. "A.B.C." me kohëzgjatje prej 36 muajsh, d.m.th. ne kohen kur është dorëzuar oferta qe është ne proces te ankesës, 1.Kjo kontrate ka qen e pa përfunduar dhe nuk munde te merret për baze ne këtë vlerësim; 2.Titulli i kontratës është Mirëmbajtja e objekteve te administratës komunale ne Prizren, 3.Mungon Referenca, edhe pse ka një reference me tjetër titull qe po përputhet numri brendshëm i prokurimit, kjo është ne kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK. Kontrata me numër rendor 15. Me vlerë 322,281.50 euro, Kontrata është nënshkruar me 03.08.2022 me kohëzgjatje prej 36 muajsh, d.m.th. ne kohen kur është dorëzuar oferta qe është ne proces te ankesës, kjo kontrate ka qenë e pa përfunduar dhe nuk munde te merret për baze ne këtë vlerësim. Referenca e paraqitur për këtë kontrate është e pa vlefshme sepse, ne ketë reference edhe AK-ja e ka shënuar qe punimet janë e kryer pjesërisht, e qe është në kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK.
- *Pretendimi i katërt (IV):* Sa i përket pretendimi tjetër ankimore lidhur me kontratën nr. me numër rendor 15 me vlerë 322,281.50 euro, ku ankuesi potencon se kontrata është nënshkruar me 03.08.2022 me kohëzgjatje prej 36 muajsh, d.m.th. në kohën kur është dorëzuar oferta, që është në proces të ankesës, kjo kontratë ka qenë e pa përfunduar dhe nuk mund të merret për bazë në këtë vlerësim. Gjithashtu, referenca e paraqitur për këtë kontratë është e pa vlefshme sepse në këtë reference edhe AK-ja e ka shënuar që punimet janë kryer pjesërisht, e që është në kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK.
- *Pretendimi i pestë (V):* OE ankues pretendon se lista e kontratave, duhet të merren parasysh vetëm nga data 13.10.2022 deri me 13.10.2019 dhe kontrata e OE të rekomanduar që plotësojnë kushtin arrijnë vlerën 629,094.53 euro.
- *Pretendimi i gjashtë (VI):* OE ankues se drejtori i zyrës së prokurimit Artan Fejza ka vepruar ne kundërshtim me vendimin e OSHP-s nr.373/23, ku të njëjtit do duhet ti revokohet certifikata e prokurimit konform nenit 25 par 8 , tutje OE ankues potencon se arsyetimi i të njëjtit është për keqardhje, kamuflimi dhe manipulimi me dëshmi e tenderit dhe dokumentet e tenderit për përfitime personale dhe inate personale me kompaninë e tyre është vepër penale, duke keqpërdor 47,680.59 euro të buxhetit të Republikës se Kosovës dhe se i njëjtit ka vonuar Policin e Kosovës për realizimin e këtij projekti për me shumë se 270 dite pasi që për 30 dite max do duhet te kryhet vlerësimi qe nga dita e dorëzimit të tenderit kanë kaluar

me shumë se 9 muaj.

Ekspertet shqyrtues me datën 26.10.2023 kanë dorëzuar raportin e ekspertizës duke rekomanduar që: "*ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda te kthehet ne rivlerësim*". Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të gjitha palët procedurale. AK lidhur me mendimin e ekspertit ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me mendimin dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Me tutje, lidhur me pretendimet e OE "Astraplan" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0762 ka vlerësuar si në vijim:

- *Konstatimi i parë (I):* Lidhur me mjetin e kontestuar eksperti teknik jep përgjigjeje si në vijim: Eksperti teknik konsideron se në bazë të dokumenteve të ofruara në dosjen e tenderit sa i përket kërkesës "Një autovinç (kamion për bartje te materialeve ndërtimore min 7ton". Në përshkrimin e kërkesës AK e ka lënë të paqartë kërkesën pasi që makineria Autovinç dhe kamion për bartje të materialeve ndërtimore dallojnë si makineri. OE ankues ka dhëne sqarimet ne piken ankimore. Sipas sqarimeve te dhëna ne ankesën e OE dhe dokumenteve te ofruara ne dosjen e tenderit (shih foto me poshtë) janë dhënë edhe rekomandimet. Eksperti teknik gjatë vlerësimit ka verifikuar të gjitha dëshmitë dhe sipas këtyre dokumenteve dhe dëshmive OE ankues ka plotësuar kërkesën edhe për autovinç edhe kamion për bartje, cila do qoftë kërkesa e AK (pasi që kërkesën e AK konsideroj që ka dykuptimësi) eksperti teknik jep sqarimin se kërkesa e autoritetit kontraktues konsiderohet e plotësuar nga OE ankues "Astraplan". Andaj bazuar në dëshmitë si më poshtë eksperti teknik konsideron se pretendimi lidhur me makineri është i bazuar.
- *Konstatimi i dytë (II):* Ekspertja shqyrtuese sqaron se kërkesat e tilla bëjnë pjesë tek Kërkesat e përshtatshmërisë dhe se dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga ofertuesi fitues, përpara publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, që do të thotë se ofertuesi do të refuzohet, do të humbasë garancinë e sigurisë së ofertës dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë. Thuhet tek Kërkesat e përshtatshmërisë dhe Dëshmia e kërkuar dokumentare. Ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar në platformën e prokurimit, ka hasur në kërkesën e AK të datës 14.09.2023, drejtuar OE të rekomanduar për kontratë "Pro & Co Group SH.P.K."- Prishtinë, lidhur me sjelljen e dokumenteve sipas dosjes së tenderit nenin 6.4. të DT. Po ashtu bazuar në platformën e prokurimit kemi hasur në dëshmitë e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrata lidhur me ketë kërkesë. Andaj pretendimi ankimor është i pa bazuar.
- *Konstatimi i tretë (III*): Lidhur me këtë kërkesë, ekspertja shqyrtuese sqaron se AK në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratat ka kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofroj

dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për natyrës së njëjtë apo të ngjashme jo më pak se 1,000,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, të cilat duhet të dëshmohen me referenca ose raporte përfundimtare të pranimit teknik në kopje të nënshkruara dhe vulosur nga autoritetit përkatës për punët e realizuara dhe pranuara, të cilat duhet te tregojnë numrin e prokurimit ose kontratës vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës natyrën e punës dhe vendin e realizimit të punëve …Lidhur me këtë kërkesë, ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar në shkresat e lëndës në e-prokurim, përkatësisht në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, i njëjti ka bashkangjitur me ofertë dokumentet me titull "04. Lista e projekteve dhe referencat-Ndërtimi i Larte_PCG.pdf" dhe "04.1 Lista e projekteve dhe pranimet teknike me referenca "Pro Co Group" pdf", ku në këto dy dokumente ka kontrata dhe referenca për punë të kryera. Sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me kontratën me numër rendor 14 tek lista "04. Lista e projekteve dhe referencat-Ndërtimi i Larte_PCG.pdf", Ekspertja shqyrtuese sqaron se kontrata me titull "Renovimi i objekteve të Administratës Komunale Prizren" e nënshkruar me datë 27.04.2020 dhe përfunduar me datë 02.12.2021 në vlerë prej 459,990.26 euro, e lidhur me AK Komuna e Prizrenit, ku për këtë kontratë, OE i rekomanduar e ka përfshirë këtë kontratë në listën e kontratave për punë të përfunduara dhe ka prezantuar referencën nga Komuna e Prizrenit për këtë kontratë. Referenca në emër të kësaj kontratë mban titullin "Renovimi i objekteve të Administratës Komunale Prizren" me numër të prokurimit: 622-19-217-211, ndërsa OE ankues pretendon në ankesë se titulli është Mirëmbajtja e objekteve te administratës komunale ne Prizren, dhe se mungon referenca, edhe pse ka një reference me tjetër titull qe po përputhet numri brendshëm i prokurimit, kjo është në kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK.

- *Konstatimi i katërt (IV):* Ekspertja shqyrtuese pas hulumtimit dhe kërkimit në platformën e e-prokurimit të kësaj reference, duke hulumtuar me numrin e prokurimit 622-19-217-211, kemi hasur në njoftimin për kontratë të publikuar me datë 03.12.2019, me titull të aktivitetit të prokurimit "Mirëmbajtja e objekteve të Administratës Komunale në Prizren", numër të brendshëm të prokurimit 622-19-217-211 dhe me numër të prokurimit 622-19-9123-2-1-1, dhe kontratën. Pra, në bazë të këtij njoftimi për kontratë të publikuar nga KK Prizren, dhe kontratës rezulton se titulli i kontratës në referencën e dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk është i njëjtë me titullin sikurse në njoftimin për kontratë dhe kontratën e publikuar. Andaj, autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit konform nenit 72 të LPP-së, duhet ta sqaroj ketë pretendim të OE ankues për këtë referencë, duke kërkuar nga AK Komuna e Prizrenit që të sqaroj këtë kontratë, e cila kontestohet nga ankuesi.
- *Konstatimi i pestë (V):* Ekspertja shqyrtues sqaron se kontrata kornizë mund të përfundojnë në aspektin kohor të përfundimit të punëve dhe në aspektin sasior kur përfundon sasia. Për me shumë referoju nenit 56.10 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.56.10 Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo qe Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 126 specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe ne rast të arritjes se pragut të lejuar AK nuk mund te bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.Sa i përket pretendimi tjetër ankimore lidhur me

kontratën nr. me numër rendor 15 me vlerë 322,281.50 euro, ku ankuesi potencon se kontrata është nënshkruar me 03.08.2022 me kohëzgjatje prej 36 muajsh, d.m.th. në kohën kur është dorëzuar oferta, që është në proces të ankesës, kjo kontratë ka qenë e pa përfunduar dhe nuk mund të merret për bazë në këtë vlerësim. Gjithashtu, referenca e paraqitur për këtë kontratë është e pa vlefshme sepse në këtë reference edhe AK-ja e ka shënuar që punimet janë kryer pjesërisht, e që është në kundërshtim me kërkesën e DT-s dhe NJK.

- *Konstatimi i gjashtë (VI):* Ekspertja shqyrtuese sqaron se duke marrë për bazë kërkesën e autoritetit kontraktues, përkatësisht kërkesat tek kapacitetit teknik dhe profesional Kërkesa "1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 1,000,000.00 €", dhe referencën e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontrata nga komuna e Prizrenit e datës 10.11.2022, ku ceket se "OE në fjalë ju kanë pranuar punimet e kryera pjesërisht ne bazë të kontratës ne vlerë prej 322,281.50 euro", si duke pasur parasysh rolin dhe funksionet e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik, institucion i cili është rregullator i prokurimit, ku tek interpretimi Nr.10.22.11.2022 është dhënë sqarimi se kontratat duhet të jenë të realizuara - përfunduara (jo në realizim e sipër), andaj pretendimin ankimor e kualifikojmë si të bazuar. Për më tepër, referoju interpretimit të KRPP-së.
- *Konstatimi i shtatë (VII)*: Ekspertja shqyrtuese siç e sqaroj dhe më lart, OE i rekomanduar në ofertën e tij ka bashkangjitur dy lista të kontratave, listën me titull të dokumentit "04. Lista e projekteve dhe referencat-Ndërtimi i Larte_PCG.pdf" dhe listën me titull të dokumentit "04.1 Lista e projekteve dhe pranimet teknike me referenca Pro Co Group.pdf", ku në mesin e këtyre dy listave, ka kontrata të cilat janë të përfunduara brenda periudhës së kërkuar sipas kërkesës së vendosur në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, Andaj, AK gjatë rivlerësimit duhet ti shqyrtoj këto dy lista të kontratave dhe të sigurohet nëse mbulohet kërkesa e vendosur nga vet AK për kontrata të përfunduara në vlerë prej së paku 1 milion euro.
- *Konstatimi i tetë (VIII):* Ekspertja shqyrtuese sqaron se pretendimet se personi e apostrofuar se ka inate me kompaninë e tij dhe këtë e ka bere për përfitime personale të njëjti ti revokohet certifikata etj. Ekspertja shqyrtuese konsideron se ky pretendim ankimor nuk ka të bëjë me çështje në të cilën mund të japim përgjigje sepse i gjithë vlerësimi jonë duhet të bazohet në shkresa/prova dhe argumente për secilën përgjigje që japim por nëse OE ankues ka argumente apo konsideron se mund ti dëshmon këto pretendime mundë ti drejtohet organeve tjera kompetente. Po ashtu është në kompetencë të OSHP-së, Panelit shqyrtues të ndërmerr masa ligjore ndaj autoriteteve kontraktues apo ndonjë veprimi tjetër lidhur me personat përgjegjës. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor se AK ka vonuar ketë aktivitet të prokurimit me shumë se 9 muaj, ekspertja shqyrtuese sqaron se pretendimi i OE ankues lidhur me tej zgjatjen e afateve të vlerësimit të ofertave është i bazuar për faktin se edhe në raste kur natyra e aktivitetit të prokurimit është shumë komplekse, AK duhet që brenda 50 dite (1 muaj e 20 ditë) të përfundoj ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas nenit 40.3 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik. Pra kjo dispozitë ligjore e ka kufizuar vlerësimin e ofertave dhe nuk mund të zgjatet më shumë afati për vlerësim se 1 muaj e 20 ditë. Dhe ky pretendimi propozoj të trajtohet si gjykuar sipas nenit 16, par. 3 të Rregullores nr. 01/2020 të Organit Shqyrtues në kuptim të nenit 105 nënparagrafit 2.16 të LPP-së, me vendim Psh.nr. 356, 373 dhe 389/2023 të datës 01.08.2023. Prandaj bazuar ne atë qe u përshkrua si me larte ankesa e operatorit ekomomik ankues është e bazuar ndërsa propozimi i ekspertit shqyrtues/teknik për AK- Policia e Kosovës, është qe lenden ta kthej në ri vlerësim me qellim qe të aplikohen në tërësi dispozitat e LPP-se ne fuqi , konkretisht nenit 59 dhe 72 i LPP-se dhe të pasqyrohet gjendja reale e ofertave në raport me kërkesa e

vendosura nga vet AK.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Astraplan" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumentet e tjera. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të dy ekspertëve shqyrtues profesional dhe teknik. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE janë të bazuara.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit publik ka pasur edhe ekspertizë paraprake tjetër me nr. 2023/0762 të datës 22.06.2023, ku edhe aty është konfirmuar se pala ankimor është e përgjegjshme dhe AK duhet ti zbatoj në tërësi dispozitat ligjore të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Paneli Shqyrtues konsideron se rrjedha e aktivitetit të prokurimit, nuk karakterizohet në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat në raport me qëllimin e synuar të këtij aktiviteti të prokurimit, nga pikëpamja e këtij Paneli, janë implementuar me kujdesin e shtuar dhe në mënyrë profesionale.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **Astraplan SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: